

Dalës-Izlazna

Nr. -1-58

Data 18.05.2023

Br.

Datum

OBILIQ-OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.25.04.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi, Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, përf.e KFOR-it, Adem Haliti, zyrtar për informim

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rishqyrtimi i Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit
4. Shqyrtimi i kërkesës për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022
5. Bartja e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023
6. Raporti financiar i shpenzimeve Janar – Mars 2023
7. Dhënia në debat publik e Planit të veprimit për transparencë 2023 - 2027
8. Shqyrtimi i kërkesës për kompensimin e Kryetarëve të Këshillave lokale
9. Raport nga Komisioni përzgjedhës për drejtor në SHFMU "Naim Frashëri" në Breznicë
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës,
Miratohet unanimisht rendi i ditës i cekur më lartë me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet rishqyrtimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave ti rekomandohet Kuvendit komunal për rishqyrtim dhe aty do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që ky Plan komunal të rekomandohet për seancën e Kuvendit komunal dhe atje do të provojmë të japim kontributin tonë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal rishqyrtimin e Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit komunal dhe është mirë që të debatohet për rritjen e të hyrave vetanake, që është një trend i mirë.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvendin komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2022.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvendin komunal.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që kërkesa për bartjen e mjeteve të rekomandohet për seancën e Kuvendit komunal, që të bisedohet në seancë dhe atje do ti paraqesim vërejtjet, apo sugjerimet tona.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet raportin financiar të shpenzimeve Janar - Mars 2023.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ky raport financiar ti rekomandohet Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që raporti financiar i shpenzimeve Janar – Mars 2023, të rekomandohet për seancën e Kuvendit komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal raportin financiar të shpenzimeve Janar - Mars 2023.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DAP-së, për dhënien në debat publik të Planit të veprimit për transparencë 2023 -2027.

Enver Gashi – Ne jemi dakord që kjo kërkesë ti rekomandohet Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kërkesa e tillë të rekomandohet për seancën e Kuvendit komunal dhe atje bisedojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës për dhënien në debat publik të Planit të veprimit për transparencë 2023-2027.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për kompensimin e Kryetarëve të Këshillave lokale.

Enver Gashi – Ne jemi dakord që kërkesa e tillë të rekomandohet për Kuvendin komunal, por ka qenë një Komision i Kuvendit, që nuk është bërë asnjë kompensim, prandaj drejtoresha duhet të na shpjegoj pse.

Sami Ahmeti – Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, ne realisht kemi miratuar një Rregullore, e cila në nenin 16 e specifikon që Kryetarët e Këshillave lokale të kompensohen me më së shumti me 6 paga të barazvlefshme me Komitetet obligative. Ne jemi dakord, vetëm se duhet pasë kujdes dhe të shihet, duhet të ketë transparencë të nevojshme që të shihen se vërtetë a po funksionojnë ato Këshilla, apo nuk po funksionojnë. Sa i përket çështjeve tjera, edhe ne kemi qenë dakord që kompensimi i Komisioneve që kanë

marrë pjesë në zgjedhjen e Këshillave të fshatrave të bëhet për shkak se është bërë një punë e mundimshme gjatë muajve të verës, shumë shpesh me shpenzime vetanake dhe pa marrë parasysh se cili dhe qysh ka qenë kur institucioni ka bazë ligjore dhe ka mundësi në jemi që ata të kompensohen sepse institucioni ka mjete të mjaftueshme. Sa i përket pengesave ligjore, sigurisht se nuk janë brenda prej Kuvendit, por drejtoresha e ka obligim ti shohë rrugët ligjore për shqyrtimin e tyre dhe të bëjë kompensimin nëse, ka bazë ligjore, e nëse jo, ne edhe kështu jemi në shërbim të qytetarëve.

Kryesuesja - Këtu, është e vërtetë se është e specifikuar nën 16 i Rregullores konkretisht e specifikon për punën e tyre që duhet të paguhet vetëm për 6 takime brenda vitit. Mirëpo, ata paraprakisht duhet ta njoftojnë drejtoreshën e administratës, ta sjellin dokumentacionin komplet si procesverbalin e takimeve të mbajtura, përndryshe nuk mund të kompensohen.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës për kompensimin e Kryetarëve të Këshillave lokale.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet Raportin nga Komisioni përzgjedhës për drejtor në SHFMU “Naim Frashëri” në Breznicë.

Enver Gashi – Ne jemi dakord që raporti ti rekomandohet Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi për atë që raporti në fjalë të rekomandohet për seancën e Kuvendit komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomandan Kuvendit komunal Raportin nga Komisioni përzgjedhës për drejtor në SHFMU “Naim Frashëri” në Breznicë.

Pika 10 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Reis Sallova, për zhvendosjen e tregut aktual në një lokacion dhe propozoj që kjo kërkesë ti dërgohet DPUKP-së për shqyrtim, pastaj të na pajisin me dokumente përkatëse.

Enver Gashi – Ne veç jemi dakorduar që çdo kërkesë së pari duhet të trajtohet në Drejtorinë përkatëse, pastaj të vjen në Kuvend. Në këtë rast konkretisht kjo kërkesë duhet të trajtohet në DPUKP, ata duhet të vijnë me një mendim dhe natyrisht se edhe ne duhet me dhënë kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Për mos me i përsëritë fjalët e parafolësit dhe tonat që vazhdimisht në këtë seancë i themi realisht është punë e juaja çka ju vjen material me lexue, mos na keqkuptoni, por unë jam dakord që kjo kërkesë të shkoj në Drejtori. Mirëpo, kërkesa në fjalë më duket se është e pakuptimtë sepse kërkon heqjen e një investimi komunal që është bërë në një zonë për shkak se po i pengon dikujt dhe nesër mund të vjen dikush me thënë hiqne këtë Komunë se unë ua kompensoj dhe ua vendosi dikund tjetër. Sido që të jetë, le të vjen Drejtorja me konsultat dhe me këshillat e veta, në mënyrë që të dijmë edhe ne se çka mund të kontribojmë në këtë fushë. Ne jemi dakord edhe me parafolësin, që këto fillimisht të na vijnë prej Drejtorisë gjegjëse, një mendim ose kërkesë pastaj bisedojmë në seancën e Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, kjo kërkesë i dërgohet DPUKP-së, për shqyrtim e cila obligohet që në seancën e Kuvendit të sjellë dokumentacion përkatës dhe për këtë ta njoftoj Kuvendin komunal.

Pika 11 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Ne kishim pasë dëshirë që në seancë të na jepet një informacion për nënkalimet që parashihen të bëhen nën hekurudhore për lagjen poshtë rreth Kosovës B, për faktin se qytetarët e kanë bërë një kërkesë në muajin e kaluar dhe nuk kanë marrë ndonjë përgjegje. Edhe kemi disa thirrje që me përçue atë kërkesë të tyre në Kuvend, vetëm me ditë se çka është vendosë a do të jenë nënkalime vetëm për këmbësorë, apo do të jenë edhe për vetura dhe a janë bërë ato vendime në konsultim edhe me qytetarët. Kjo është njëra prej kërkesave. E kam edhe një kërkesë lidhur me mbajtësit e web faqes së Komunës. Në web faqen e Komunës janë të paktën 2 kontrata, të cilat janë komplet të palexueshme, fjala është për kontratën për vazhdimin e sheshit “Adem Preniqi” dhe kontrata e Palestrave në Mazgit dhe në Lajthishtë. Këto 2 kontrata janë komplet të palexueshme dhe në rast se ka mundësi me u ndërrue në web faqe në mënyrë që mos të kemi nevojë të bëjmë kërkesë se Kryetari tha je bë sikur me punue në arkivë. Prandaj, ne çka bëjmë kërkesa dhe çka kërkojmë nuk është detyrimisht me zënë dikend keq, por po na interesojnë sepse jemi

përfaqësues të një mase të madhe qytetare. Po ashtu, dje isha në një takim me ministren e ekonomisë, me gjasë Obiliqi kishte aplikue, është hap një program për eficiencë për banesat sociale që janë dhe kisha pasë dëshirë saktësisht me ditë se a kanë aplikue sepse është një program shumë i mirë që e ndihmon eficiencën.


Adem Haliti – Përgjegjet sa i përket kontratave në Prokurim është për herë të parë në web faqe të Komunës, që është edhe në MAPL nuk kanë punue 70 % dhe për herë të parë në Kosovë nuk ka më Komunë në renditje të parë, të dytën dhe të tretën, por të gjitha Komunitat i kanë vendosë të barabarta sepse kanë humbë shumë dokumente. Tash, dokumentet të cialt kanë humbë, unë nuk mund ta dijë se gjatë ditës vendosi dokumente të Kuvendit, kontrata, njoftime e konkurse dhe në serverat e tyre të cilat MAPL-ja, ia ka kalue ASHI-së, që është edhe kontraktor që i mban dokumentet, do të thotë ata ia kanë lënë Ministrisë për arsye se në servera nuk po mundën me i kthye dokumentet. Tash, ne edhe një herë duhet me hy me i rishikue të gjitha ato dokumente se është e mundur që kontrata është me titull, por kur klikon ta qet error dhe nuk hapet

Sami Ahmeti – Çështja nuk është te mungesa sepse ato çka i kam kërkue i kam gjetë, por çështja është vetëm te moslexshmëria. Dokumenti është i bashkangjitur, është i skanuar në formën shumë të dobët dhe nuk ke mundësi me lexue se çka po shkruan. Edhe atë kontratë unë e di se institucioni e ka, kështu që fjala është për 2 kontrata dhe nuk dua me zënë askend keq, por është punë e juaja. Është kontrata për vazhdimin e sheshit “Adem Preniqi” në mënyrë që vazhdimisht të mos bëjmë kërkesa e të bëhemi shumë byrokratik, e shehë vetë, merre skanoni edhe një herë e vendsoni në web faqe dhe jemi në rregullë. E njëjta është edhe për 2 Palestrat që i ceka më heret dhe nuk ka të bëjë me mungesë, të paktën unë nuk kam hasë, ose me humbje të ndonjë dokumenti, por fjala është për moslexueshmërinë e tyre.

Adem Haliti – Ka raste sepse web faqet e Komunave, tashmë janë bërë monotone për arsye se shpeshherë nuk hapen. Po ashtu, ka raste që unë e kam publikue dokumentin dhe i ka dalë Komunës së Drenasit dhe ka raste që i Mitrovicës ka hy me kërkue një dokument e ka dalë Komuna e Prishtinës. Këto, janë probleme që i ka MAPL-ja, e cila e ka vendos njoftimin në web faqen e vet dhe në facebook. Mirëpo, ne do ti shikojmë kontratat edhe një herë se a mundem ato kontrata me i zëvendësue me datën kur janë publikuar sepse web faqja e Komunës, nuk ta lejon datën e cila ka qenë e publikuar në atë kohë. Pikërisht, për transparencë e kanë bërë këtë për shkak të datave, që ka humbë vendimi unë i vendosi vendimet, por për shkak të kohës që nuk është reale, por është më vonë, e kanë lënë, do të thotë janë jashtë funksionit. Unë do ti shikoj nëse, është e mundur, por nuk besoj se mund ti vendosë me datën që i kam vendosë sepse ato kanë qenë në vitin 2022 dhe tash në vitin 2023 web faqja nuk ta lejon se ne jemi vetëm editues ndërsa, serverat dhe njerëzit që i monitorojnë janë në MAPL.

Mbledhja përfundoi në ora 11:26’

Bashk. prof. për punë të KK


Azize Zeneli

